



Prishtinë: 24.06.2010

Kodi i ZRRE-së: V_252_2010

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_V_406_05_10

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 16 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_413_05_10** ;
5. Apelimi i konsumatorit me datë 15.06.2010;
6. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;

Në mbledhjen e mbajtur më 24 qershor 2010 nxori këtë:

VENDIM

REFUZOHET ankesa e konsumatorit Jahi Abdiu (shifra e konsumatorit DPR – 44094) nga Fushë Kosova, si në arsyet e paraqitura të këtij vendimi.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 22.01.2009 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 29.12.2009 lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- Me datë 03.02.2009 konsumatori ka parashtruar kërkesë zyrtare pranë organeve të KEK-ut për ndërrim njehsori.

Provë: Aplikacioni për ndërrim njehsori me datë 03.02.2009

- Me datë 13.02.2009 me kërkesë të konsumatorit punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik me nr. 45447428 dhe kanë konstatuar se konsumatori nuk prezanton njehsorin e vjetër.

Provë: Vërtetim mbi ndërrimin e njehsorit elektrik nr. 005436 datë 13.02.2009

- Me datë 02.04.2009 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit si dhe kanë bërë regjistrimin e të dhënave teknike të pikës matëse.

Provë: procesverbali i KEK-ut nr. 317128 të datës 02.04.2009

- Me datë 28.05.2009 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DPR09HP07733 në vlerë prej 912.87 €.
Provë: Fatura DPR09HP07733 e datës 28.05.2009
- Me datë 14.12.2009 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.
Provë: Ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 29.12.2009 Departamenti për Konsumator në KEK i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke thirrur në procesverbalin e kontrollës.
Provë: Përgjigja e KEK-ut e datës 29.12.2009
- Me datë 22.01.2009 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.
Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së
- Me datë 26.05.2010 DMK e ZRRE-së ka nxjerrë vendim në lidhje me ankesën e konsumatorit duke e pranuar pjesërisht ankesën e konsumatorit
Provë: Vendimi i DMK-së nr. ZRRE/DMK_V_406_05_10
- Me datë 15.06.2010 konsumatori ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së, duke kundërshtuar vendimin e DMK-së nr. ZRRE/DMK_V_406_05_10.
Provë: Ankesa e konsumatorit në Bord të ZRRE-së

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: ZRRE/DMK_V_406_05_10 dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së. Apeluesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi shtesë kundër këtij Vendimi, andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë** konsumatorin për arsyet e paraqitura në vendimin e DMK të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar